

USAID-i ndihmon të rinjtë në punësim profesional

03/11/2010, "INFO PRESS"

Infopress

Prishtinë, 2 nëntor



Mbështetja e USAID-it ofruar për trajnimin dhe programet e praktikës për studentët e universitetit ka rezultuar në punësimin profesional të 75 të rinjve.

Mark Wood, drejtor i KPEP-it, ka theksuar se USAID-i e konsideron zhvillimin e fuqisë punëtore si strategji kryesore në përmirësimin e pozitës konkurruese të kompanive dhe sektorëve të Kosovës.

Pasi që e gjithë ekonomia e Kosovës, sipas tij, po lëviz drejt shekullit 21, konkurrenca në treg, zhvillimi i shkathtësive për pjesëmarrësit aktualë dhe të ardhshëm të fuqisë punëtore dhe qasja e studentëve dhe e të papunëve në vende pune e profesione të reja do të jetë kërkesë thelbësore.

"Për t'u ofruar studentëve, të papunëve dhe të punësuarve aktualë shkathtësitë të cilat i përshtaten më mirë biznesit, Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë ka organizuar disa programe të praktikës", tha Wood. Trajnimi dhe programi i praktikës në kontabilitet dhe financa, i implementuar nga Shoqata për Shërbime Financiare dhe Kontabilitetit (AFAS) ka inkuadruar 103 studentë të ekonomisë. Këta studentë kanë ndjekur programin e trajnimit dhe u vendosën si praktikantë nëpër banka dhe institucione mikrofinanciare. Deri më sot, 59 studentëve u janë vazhduar kontratat. Nga programi i praktikës për fusha të ndryshme, i implementuar nga World University Service – Austria (WUS – Austria), përfituan 40 studentë. Këta studentë u vendosën në ministri dhe drejtori të ndryshme komunale të pesë komunave. Deri më tani, 2 prej tyre u është ofruar mundësi punësimi permanent. Programi i praktikës për sektorin e prodhimeve të qumështit, i implementuar nga Nisma për Zhvillim të Bujqësisë së Kosovës (IADK), ka inkuadruar 15 praktikantë: 10 studentë fillestarë dhe 5 mentorë, të cilët ishin zgjedhur nga pilot grupi i programit të vitit 2009. Programi prapë dëshmoi të jetë shumë i suksesshëm për shkak se edhe cilësia e qumështit të prodhuar nga fermerët, që ishte po ashtu pjesë e programit, është përmirësuar, si dhe Programi i praktikës për industrinë e përpunimit të drurit, i implementuar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK), i angazhoi 16 studentë nga Fakulteti i Shkencave Aplikative dhe nga Shkolla Profesionale dhe të Zdrukthëtarisë dhe Qendra për Aftësim Profesional, të gjithë klientë të KPEP-it. Ky projekt ishte shumë i suksesshëm, për shkak se 16 studentëve u është ofruar punësim nga kompanitë ku ishin të vendosur për praktikë. Deri më sot, 14 prej tyre i kanë pranuar ofertat për punë.